REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**
**SH.A"PORTI DETAR SHËNGJIN"**

**Nr.473 Prot** **Shëngjin më: 23 08.2024**

## Lënda : Shpallie për vend të lirë pune

Mbështetur në Udhëzimin Nr.7 datë 11.06.2015 "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave të përzgjedhjes së punonjësve të Forcës së Sigurisë në portet detare të Republikës së Shqiperisë". Porti Detar Shengjin Sh.Ashpall konkursin për një vend të lirë pune në pozicionin Oficer Sigurie në Portin Detar Shëngjin. Dokumentat (kriteret) duhet të paraqiten pranë Sh.A Portit Detar Shëngjin brenda datës 24.09.2024 ora 12.00 në zarf te mbyllur. Njoftimi është shpallur në faqen web: www//***portidetarshengjin.al.***

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e percaktuara ne Udhëzimin Nr.7 date 11.06.2015 kreu IV te nenit nr 5 të ketij Udhëzimi theksohet Kërkesa të veçanta për postin e drejtorit, oficerëve të Sigurisë së Porteve dhe Zonave të Sigurisë në portin e Shëngjinit **.**

***1. Kërkesat e veçanta për postin e drejtorit /shefit të Sigurisë së Portit Shëngjin e Sarandë***

*a) Kandidatët që aplikojnë për postin e drejtorit/shefit të sigurisë së Portit Shëngjin ose Sarandë, përveç dokumentacionit të parashikuar në aneksin 1 të këtij udhëzimi, duhet të dorëzojnë një CV të detajuar të shoqëruar me diplomat dhe certifikatat origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. CV-ja duhet të specifikojë arsimin, trajnimet, eksperiencën dhe aftësitë e kandidatit për të menaxhuar dhe për të drejtuar një forcë të sigurisë portuale dhe të përfshijë përvojën, njohuritë dhe dijet në fushat e mëposhtme:*

- *menaxhim;*
- *udhëheqje;*
- *detari;*
- *siguri;*
- *etikë;*
- *legjislacionin për Forcat e Sigurisë;*
- *kodi ISPS i Organizatës Ndërkombëtare Detare.*

*b) Kriteret e veçanta që duhen mbajtur parasysh gjatë intervistës dhe testimit me shkrim për përzgjedhjen e kandidatit për postin e drejtorit/shefit të Sigurisë së Portit Shëngjin ose Sarandë, janë:*

- *Të ketë përfunduar arsimin e lartë, preferohet Fakulteti i Navigacionit, Akademia e Marinës.*

*Në rast se nuk ka konkurrent nga profili i marinës, kandidati mund të pranohet dhe me profil të Akademisë së Policisë ose të Akademisë Ushtarake;*

*- Të ketë eksperiencë në punë 5 vjet ose më shumë, preferohet të ketë punuar si kapiten anijeje, oficer i sigurisë në anije, oficer sigurie në Forcat e Sigurisë në Port ose të ketë eksperiencë pune të paktën 7 vjet si oficer në forcat e policisë ose të ushtrisë;*

*- Të ketë aftësi të mira komunikuese, drejtuese dhe negociuese;*

*- Të veprojë në mënyrë etike;*

*- Të njohë procedurat që kërkohen për zbatimin me efektivitet të legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar lidhur me rregullat e sigurisë në porte dhe anije. Të njohë rregullat e bashkëveprimit të forcës së sigurisë me anijen. Të njohë kuadrin ligjor në fushën e detarisë, si: Kodin Detar të Republikës së Shqipërisë, ligjin për sigurinë në anije dhe porte dhe kuadrin ligjor ndërkombëtar në fushën e sigurisë veçanërisht Kodin e Sigurisë në anije dhe porte, i IMO-së (ISPS);*

*- Të ketë njohuri mbi ligjin për emergjencat civile, mbrojtjen kundër zjarrit dhe procedurat për parandalimin dhe reagimin ndaj tyre;*
*- Të ketë njohuri të mira për gjuhën angleze në të folur dhe në të shkruar.*
*2. Kërkesat e veçanta për postin e Oficerit të Sigurisë së Portit Shëngjin e Sarandë*

*a) Kandidatët që aplikojnë për postin e oficerit të sigurisë së Portit Shëngjin ose Sarandë, përveç dokumentacionit të parashikuar në aneksin 1 të këtij udhëzimi, duhet të dorëzojnë një CV të detajuar të shoqëruar me diplomat dhe certifikatat origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. CV-ja duhet të specifikojë arsimin, trajnimet, eksperiencën dhe aftësitë e kandidatit për të menaxhuar dhe drejtuar një forcë të sigurisë portuale dhe të përfshijë përvojën, njohuritë dhe dijet në fushat e mëposhtme:*

*- menaxhim;*
*- udhëheqje;*
*- detari;*
*- siguri;*
*- etikë;*
*- legjislacionin për Forcat e Sigurisë;*
*- kodi ISPS i Organizatës Ndërkombëtare Detare.*

*b) Kriteret e veçanta që duhen mbajtur parasysh gjatë intervistës dhe testimit me shkrim për përzgjedhjen e kandidatit për postin e oficerit të sigurisë së Portit Shëngjin ose Sarandë, janë:*

*- Të ketë përfunduar arsimin e lartë, në fushën e navigacionit, Akademinë e Marinës, inxhinieri navale.*

*Në rast se nuk ka konkurrent nga profili i marinës, kandidati mund të pranohet dhe me profil të Akademisë së Policisë ose Akademisë Ushtarake;*

*- Të ketë eksperiencë në punë 5 vjet ose më shumë, preferohet të ketë punuar si kapiten anijeje, oficer i sigurisë në anije, oficer sigurie në Forcat e Sigurisë në Port, ose specialist në shoqëritë e Menaxhimit të Sigurt ose të ketë eksperiencë pune të paktën 7 vjet si oficer në forcat e policisë apo të ushtrisë;*

*- Të ketë aftësi të mira komunikuese, drejtuese dhe negociuese;*

*- Të veprojë në mënyrë etike;*

*- Të njohë procedurat që kërkohen për zbatimin me efektivitet të legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar lidhur me rregullat e sigurisë në porte dhe në anije. Të njohë rregullat e bashkëveprimit të forcës së sigurisë me anijen. Të njohë kuadrin ligjor në fushën e detarisë, si: Kodin Detar të Republikës së Shqipërisë, ligjin për sigurinë në anije dhe porte dhe kuadrin ligjor ndërkombëtar në fushën e sigurisë, veçanërisht Kodin e Sigurisë në anije dhe porte, i IMO-së (ISPS);*

*- Të ketë njohuri mbi ligjin për emergjencat civile, mbrojtjen kundër zjarrit dhe procedurat për parandalimin dhe reagimin ndaj tyre;*

*- Të ketë njohuri për përgatitjen e vlerësimit të rrezikut dhe planet e sigurisë në anije dhe porte;*
*- Të ketë njohuri të mira për gjuhën angleze në të folur dhe në të shkruar (dëshmi gjuhe);*
*3. Kërkesat e veçanta për postin e oficerit të sigurisë së Zonave të Sigurisë të Portit Shëngjin e Sarandë dhe/ose shefave të turnit.*

*a) Kandidatët që aplikojnë për postin e oficerit të Sigurisë së Zonave të Sigurisë të Portit Shëngjin e Sarandë dhe/ose shefave të turnit, përveç dokumentacionit të parashikuar në aneksin 1 të këtij udhëzimi, duhet të dorëzojnë një CV të detajuar, të shoqëruar me diplomat dhe certifikatat origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. CV-ja duhet të specifikojë arsimin, trajnimet, eksperiencën dhe aftësitë e kandidatit, për të menaxhuar dhe për të drejtuar një forcë të sigurisë portuale dhe të përfshijë përvojën, njohuritë dhe dijet në fushat e mëposhtme:*

*- menaxhim;*
*- udhëheqje;*
*- detari;*
*- siguri;*
*- etikë;*
*- legjislacionin për Forcat e Sigurisë;*
*- kodi ISPS i Organizatës Ndërkombëtare Detare.*

*b) Kriteret e veçanta që duhen mbajtur parasysh gjatë intervistës dhe testimit me shkrim për përzgjedhjen e kandidatit për postin e Oficerit të Sigurisë së Zonave të Sigurisë së Portit Shëngjin e Sarandë dhe/ose shefave të turnit, janë:*

*- Të ketë përfunduar arsimin e lartë, në fushën e navigacionit, Akademinë e Marinës, inxhinieri navale.*

*Në rast se nuk ka konkurent nga profili i marinës, kandidati mund të pranohet dhe me profil të Akademisë së Policisë ose Akademisë Ushtarake.*

*- Të ketë eksperiencë në punë 5 vjet ose më shumë, preferohet të ketë punuar si oficer i Sigurisë në Anije, Oficer Sigurie në Forcat e Sigurisë në Port, ose specialist në shoqëritë e Menaxhimit të Sigurisë ose të ketë eksperiencë pune në Kapitenerinë e Portit ose të ketë eksperiencë pune të paktën 7 vjet si oficer në forcat e policisë apo të ushtrisë.*
*- Të ketë aftësi të mira komunikuese, drejtuese dhe negociuese;*
*- Të veprojë në mënyrë etike;*
*- Të njohë procedurat që kërkohen për zbatimin me efektivitet të legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar, lidhur me rregullat e sigurisë në porte dhe anije. Të njohë rregullat e bashkëveprimit të forcës së sigurisë me anijen. Të njohë kuadrin ligjor në fushën e detarisë, si: Kodin Detar të Republikës së Shqipërisë, ligjin për sigurinë në anije dhe porte dhe kuadrin ligjor ndërkombëtar në fushën e sigurisë, veçanërisht Kodin e Sigurisë në anije dhe në porte, i IMO-së (ISPS);*
*- Të jetë trajnuar dhe certifikuar mbi sigurinë në anije dhe në port;*
*- Të ketë njohuri për përgatitjen e vlerësimit dhe planet e sigurisë në anije dhe porte;*

*- Të ketë njohuri të mira për gjuhën angleze në të folur dhe në të shkruar.*
*4. Kërkesa të veçanta për punonjësit e tjerë të forcave të sigurisë*

*a) Kandidatët që aplikojnë për të ushtruar detyrën si efektiv i Forcave të Sigurisë të Portit Shëngjin ose Sarandë, përveç dokumentacionit të parashikuar në aneksin 1 të këtij udhëzimi, duhet të dorëzojnë një CV të detajuar, të shoqëruar me diplomat dhe certifikatat origjinale ose kopje të noterizuara të tyre, e cila duhet të specifikojë aftësitë e kandidatit për të realizuar detyrat e kërkuara nga ligji për sigurinë në anije dhe porte, ku të përfshijë eksperiencën e tij, në punë në porte ose anije dhe të ketë njohuritë e dijet në fushat e mëposhtme, përveç kërkesave të përgjithshme të shprehura në nenin 2:*

*- Të njohë veprimtarinë në portin ku do të emërohet dhe anijet dhe të jetë i trajnuar me detyrat specifike që kërkon ky shërbim;*
*- Të veprojë në mënyrë etike;*
*- Të ketë aftësi komunikuese.*

**Dokumentat (kriteret) duhet te paraqiten prane Sh.A Portit Detar Shengjin brenda dates 25.09.2024 ora 12.00.**

**DREJTORI**

**SANDER MARASHI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SH.A. PORTI DETAR
SHENGJIN